BASHKIA TIRANË

AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT

APR

# Pajisja me sinjalistike, sistem monitorimi, uniforma dhe arme per inspektim

BASHKIA TIRANË

AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
APR

# Objektivi

Projekti synon standartizimin e pajimeve te Inspektorit te Parkut si mbeshtetje ndaj përgjegjësive për mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e tij. Pajimet e permendura ne kete projekt synojne te ndikojne ne menyre te drejteperdrejt ne zbatimin me me shume korrektesi dhe thjeshtesi te detyrave organike te Inspektorëve te Parkut. Si shembull per kete projekt jane marre vende te ndryshme te Bashkimit Evropian, si dhe shtete te ndryshme te Shteteve te Bashkuara te Amerikes. Inspektoret e Parkut kane disa detyra funksionale si:

1. Te sigurojnë që vizitorët zbatojnë dhe respektojnë rregullat e parkut.
2. Siguria e parqeve
3. Parandalimi i zjarreve.
4. Mosdemtimi dhe mos shkaterrimi i flores dhe i faunes.
5. Ruajtja e hapesirave publike.
6. Ruajtja e infrastruktures dhe i veprave te ndryshme.

# Objektivi

Inspektoret e Parkut patrullojnë në terren të gjithë zonën ,shtigjet dhe hapësirat përreth deri në kufijtë e tij. Gjate patrullimeve evidentohen problematika te ndryshme. Terreni ne te cilin patrullon nje inspektor jane shtigje pyjore ose zona rralle te frekuentuara edhe larg zonave te banuara. Rreziqet qe mund te vijne prej problemeve te hasura pergjat patrullimit jane te perbashketa me vendet e tjera si motra ne BE dhe ne SHBA. Shembulli i pajimeve te marra ne kete projekt i standartizon inspektoret dhe i hap dyert drejt trajnimeve te perbashketa me agjensi si motra.



BASHKIA TIRANË

# Pershkrimi i uniformave




Tabela 1

BASHKIA TIRANË

# Pershkrimi i uniformave

Sipas tabeles 1, ekzistojne 4 lloje modele uniformash. Secila e pershtatur sipas stines, detyres dhe funksionit te inspektorit. Inspektoret e Parkut kane nje rol te rendesishem ne prezantimin e rregullave dhe sjelljes qytetare ne park qe sherben ne rritjen e ndergjegjesimit publik.









BASHKIA TIRANË

AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT APR

# Problematikat kryesore

Duke u bazuar ne rrefimet e inspektoreve qe jane gjendur ne situata nga me te ndryshmet disa nga problemet kryesore me te hasura jane:

1. Sulmet nga kafshe te egra te ndryshme (derri i eger, ariu, zvarranik dhe ujqer)
2. Rreziku nga zjarret gjate stines se veres.
3. Rreziku i jetes nga personat qe kryejne krime mjedisore.
4. Rreziqe natyrore.

BASHKIA TIRANË

APR

# Sulmet nga kaf e te egra te ndryshme

Sipas te dhenave nderkombetare rastet me te shpeshta te sulmeve jane nga kafshe te vogla, zvarranik dhe insekte.

Nje kafshim nga nje gjarper helmues pergjate nje shtegu larg zonave te banuara sjell deri ne rrezik per jeten per inspektorin ose udhetar te rastit. Per kete arsye, kutia e ndihmes se shpejte eshte nje mjet i domos-doshem ne canten e cdo inspektori pyjor.



# Sulmet nga kaf    e te egra te ndryshme

Radio komunikimi me te pakten 2 metoda komunikimi. Si metoda UHF / VHF dhe metoda GMS. Nje GPS eshte gjithashtu i detyrueshem kur inspektori ndodhet i vetem dhe i pa afte per te levizur.  Ne raste sulmi nga kafshe te egra te mesme ose te medha eshte vene re se sprajtet me piper kane qene shume efektive ne mbrojtjen e inspektorit.







BASHKIA TIRANË

# Rreziku a zjarret gjate stines se Veres

Më shumë se 500 hektarë me pyje janë shkatërruar në 5 vitet e fundit në vend, si rrjedhojë e dukurive natyrore, shfrytëzimit pa kriter apo zjarreve. Ekspertët e mjedisit rekomandojnë pervec shtimit te hapësirave të gjelbërta, duhen shtuar dhe masat mbrojtese per hapesirat e gjelberta ekzistuese.

Sipërfaqa e gjelbër në Shqipëri po reduktohet nga viti në vit. Sipas të dhënave të raportuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), në 5 vitet e fundit janë "zhdukur" 509 hektarë sipërfaqe me pyje.

| Viti | Pyje | | Kullota | | Sipërfaqe me bimësi pyjore dhe jo-produktive | | Gjithsej | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Sip.Ha | % | Sip.Ha | % | Sip.Ha | % | Sip.Ha | % |
| 2015 | 1.052.253 | 60,4 | 478.188 | 27,5 | 210.456.3 | 12,1 | 1.740.897 | 100 |
| 2016 | 1.052.237 | 60,4 | 478.188 | 27,5 | 210.456.3 | 12,1 | 1.740.880 | 100 |
| 2017 | 1.051.871 | 60,4 | 478.081 | 27,5 | 210.387.8 | 12,1 | 1.740.339 | 100 |
| 2018 | 1.051.859 | 60,4 | 478.081 | 27,5 | 210.383.4 | 12,1 | 1.740.324 | 100 |
| 2019 | 1.051.843 | 60,4 | 478.081 | 27,5 | 210.382.5 | 12,1 | 1.740.307 | 100 |

BASHKIA TIRANË

# Rreziku a zjarret gjate stines se Veres

Gjate kryerjes se detyres gjate veres veshja qe do te kete inspektori duhet te plotesoje standarte qe atij ti ofrojne siguri dhe ne raste zjarresh. Sipas eksperiencave nderkombetare materiali NOMEX i perdorur tek kemisha dhe pantallonat, si dhe kepucet e gomes kunder zjarrit, kane rezultuar te suksessheme ne mbrojtjen e jetes se inspektorit. Pergjate zjarreve stinore, perpara se keto te fundit te kthehen ne dukuri inspektori pyjor mund te ndodhet ne patrullim kur shtegu ose rruga e tij e kthimit mund te jete nderprere nga rreziku qe shkaktojne keto zjarre.

# Rreziku a zjarret gjate stines se Veres

Kjo gje e detyron inspektorin qe te perdore nje rruge dytesore per tu rikthyer dhe ne rast se nje e till nuk ekziston ai eshte i detyruar te krijoj nje shteg per te kaluar. Per kete arsye ne canten e inspektorit pyjor nuk duhet te mungojne dylbite e vrojtimit, streha e zjarrit, nje shat per hapjen e shtigjeve doreza kunder zjarrit dhe nje kapele e forte per tu mbrojtur nga nxehtesia, deget ose shkurret e ndryshme.







BASHKIA TIRANË

APR

AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT

# Rreziku. a zjarret gjate stines se Veres



# Rreziku i jetes nga persona qe kryejne krime mjedisore

Duke u bazuar ne rrefimet e inspektoreve rrezikun e trete me te larte per ta e kane sjelle njerez te tjere qe kryenin krime mjedisore ne zonat ku inspektori patrullonte. Disa nga krimet mjedisore pervec zjarrevenies se qellimshme jane dhe shpyllezimi per perfitimin e materialit drusor, gjuetia ne zonat e ndaluara, nxjerrja nga toka e mineraleve te cmuara. Grabitje te vogla ndaj turisteve ne zone. Te mirat monetare qe perfitohen nga keto lloj krimesh krijon perballjen e ketyre individeve me inspektoret pyjor.

BASHKIA TIRANË

APR

# Rreziku i jetes nga persona qe kryejne krime mjedisore

Ne eksperiencat nderkombetare mospajisja e inspektoreve pyjor me mjete te domosdoshme per vetmbrojtje krijonte mungesen e kontrollit ne zonat me rrezikshmeri me te larte dhe si pasoje moskryerjen e detyres ne menyren e duhur. Per te gjitha keto arsye si pjese e pajimeve te inspektorit jane te domosdoshme pistoletat elektrike. Efikasiteti i tyre sherben vetem per vetmbrojtje. Gjithashtu per te evidentuar dhe verifikuar ne raste nevoje perdorimin e tyre inspektoret duhet te pajisen me kamera trupi.





BASHKIA TIRANË

AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
APR

# Rreziqet Natyrore

Rreziku i katert per nga statistikat e ndodhive, jane rreziqet natyrore, arsyeja pse rreziqet natyrore renditen te katertat ne listim eshte sepse ato shpesh parashikohen, tek keto rreziqe hyjne, rreshkitja e dherave pas reshjeve te dendura, fryrja e lumenjve ose permbytjet e zonave te caktuara pyjore.  Ne baze te eksperiencave te ndryshme sistemi i lokalizimit me GPS te inspektoreve pyjor ne rastet kur patrullimi eshte i domosdoshem dhe kur rreziku nga shkaqet natyrore eshte i larte eshte zgjidhja e vetme se si inspektori mund te ndihmoj dhe te ndihmohet. (Kur inspektori eshte pjese e grupit te shpetimit te derguar ne nje zone te caktuar)